1. Sa investim nevojitet për fillimin e biznesi të zakonshëm dhe sa për nisjen e një biznesi MLM. Nëse në rastin e parë mund të mendoj vetëm në nivele milionash, i dyti është shumë i favorshëm, mund të niset me investim minimal dhe s'ka rrezik! Si mund të fitohet para pa kapital? Duke qenë i hapur ndaj njerëzve, duke i dashur ata dhe duke siguruar njohuritë e duhura. E dini se çfarë është kjo? PUNA E DASHURISË. Këtu njerëzit janë plot me jetë, energji, entuziazëm dhe dashuri. Ajo që çdo zog shqiponje vë re: këtu të gjithë janë të rinj, këtu të gjithë janë fitt, këtu të gjithë buzëqeshin.

2. Sa kohë më merr? Në tregëtinë e zakonshme në 24 orë të ditës nevojitet prania e vazhdueshme e tregëtarit. Mungesa e tregëtarit është e papranueshme sepse nëse ai nuk punon, kjo sjell uljen e të ardhurave të tij. Kurse MLM-ja përveç faktit që të lejon një ndarje elastike të kohës, thekson edhe përparësitë e punës në skuadër.

Kështu që të ardhurat tona i marrim jo vetëm në bazë të punës sonë, por edhe të asaj të skuadrës sonë, dhe së bashku arrijmë më shumë (ndoshta mund të shkojmë të qetë edhe për pushime verore)

3. Përse pikërisht **FLP**-ja?

Një **kompani e njohur, stabile në treg, me kapitale të forta**, me një të kaluar dhe përvojë afërsisht 30 vjeçare. Një kompani e cila s'ka patur kurrë borxhe dhe s'merr pjesë në bursë. Një kompani e cila funksionon zyrtarisht në 120 vende të botës. Një kompani ku gjithçka përqendrohet në një dorë. Rex Maughan, i cili në Amerikë është zgjedhur dy herë si njeriu i vitit, i cili ka një personalitet të magjishëm, i cili deri tani ka ndryshuar jetën e mijëra njerëzve.

4. FLP-ja prej vitit 1978 shërben me **produkte me cilësi të shkëlqyer** kërkesat gjithmonë e në rritje në tregun e shëndetit dhe kozmetikës. Produktet e veçanta, me efekt sensibilizues, cilësi të lartë dhe çmim të pagueshëm të kompanisë blihen vazhdimisht nga blerësit, pra një artikull konsumi që plotëson kërkesa reale. Cilësia e përsosur shoqërohet

me një garanci kthimi 30 ditore dhe shërbim të garantuar.

5. Kësaj i shoqërohet një **plan marketing i drejtë**, stabil dhe korrekt, i cili shmang shpenzimet e panevojshme të tregëtisë së zakonshme, nuk përdor shkallët e zakonshme të tregëtisë, dhe produktet shkojnë menjëherë nga prodhuesi tek konsumatori.

6. **Shpërblimi** i vazhdueshëm dhe i paguar në kohë që **vjen sipas qarkullimit**, i cili llogaritet përditë dhe mund të kontrollohet thjeshtë. Këtu me të vërtetë shpërblehet rendimenti dhe gjithmonë vlerësohet ai që e meriton, ai që ka punuar për të. Në një biznes të zakonshëm pak a shumë mund të llogaritet që me investimin e kapitalit dhe punës personale sa të ardhura mund të presësh. Në FLP nuk ka tabelë pagash, të ardhurat s'kanë limit, dhe ka **të drejtë autori!**

7. Kjo është një mundësi për të krijuar **siguri materiale dhe pavarësi financiare**. Çdo të thotë pavarësia për njerëz të ndryshëm? Për mua që të mos më duhet të

bëj atë që nuk dëshiroj. Këtu je i pavarur nga të tjerët, varesh vetëm nga vetja jote. Ti e vendos se kur, me kë dhe sa punon.

8. Përveç vlerësimit material është shumë i rëndësishëm edhe **vlerësimi moral**, falenderimet e shumta që të japin energji. Kur bashkëpunonjësi yt të thotë: "Jam krenar për ty dhe gëzohem që ti je sponsori im". Faleminderit Erika për besim tënd! "Mirësia është i vetmi investim që shpërblehet"

9. S'ka çmim hyrjeje, s'ka paketë të detyrueshme nisjeje, s'ka çmim anëtarësie, s'ka çmim rinovimi karte, s'ka detyrim blerjeje. Por mund të sigurosh një kartë tregëtie me shumicë, pa pegesë, për gjithë jetën, e cila të fton në një udhëtim të pafund.

10. Veprimtari e dobishme dhe me vlerë, sepse mund të ndihmoj të tjerët nga ana **shëndetësore dhe materiale** gjithashtu. Duke ndjekur një mënyrë jete të shëndetshme rritet mundësia e ruajtjes së shëndetit. Duke e parë nga ana materiale, u jap në dorë njerëzve që të nxjerrin në sipërfaqe aftësitë e tyre më të mira. Është e pabesueshme pasuria e pamatshme që mund të sigurojmë gjatë punës sonë. Pasuri e cila s'do të thotë vetëm mirëqenie materiale, por edhe zhvillimin tonë. Nën hijen e një diturie të madhe jepet mundësia e zhvillimit personal.

11. Njohja e njerëzve të rinj, krijimi i **miqësive të reja që zgjasin tërë jetën**. Këtu mund të radhis një listë shumë të gjatë. Adit dhe Agi nga Ujfeherto; Erika dhe Anti nga skuadra ime e Gavavencselló janë lojtarë të vërtetë skuadre. Është ndjenjë e mirë të dish se rrethohesh nga njerëz për të cilët është i rëndësishëm edhe sukcesi i të tjerëve. Por këtu është e mundur edhe rilindja dhe thellimi i mëtejshëm i miqësive të vjetra – faleminderit Gabo që gjallëron skuadrën time nga Nyiregyhaza!



12. Mundësi udhëtimi të jashtëzakonshme në vendet më të bukura të botës. Drejt Stockholmit! Programi i blerjes së makinës, programi i ndarjes së fitimit.

Pra, kështu filloi përse-ja ime. Secili ka përse-n e tij. Duhet ta kesh përse-n tënde. Se sa e madhe është, ajo është puna jote. Por të jetë e fortë! **Nëse përse-ja është e fortë, përgjigjia vjen vetë.** Vetëm të dish se përse. Është e rëndësishme të gjesësh shkaqet se PËRSE dëshiron të bëhesh i suksesshëm, përse ka rëndësi suksesi për ty. Ndoshta pas përse-ve të tua nuk qëndrojnë shkaqe financiare, por për realizimin e tyre nevojitet një sfond financiar. Përgjigjen e pyetjes e ke në dorë. Që përse-ja jote është aritja e sigurisë materiale, apo krijimi i shtëpisë së ëndërruar, apo një udhëtim rreth botës, apo blerja e një makine lluksoze, apo thjesht të bësh një diçka tjetër, të pazakontë. Këtë duhet ta dish ti.

Në janar të 2006-ës, kur pas disa përpjekjesh ndërtimi i biznesit nuk filloi ashtu siç e planifikova, morra vendimin: tani do të dalim jashtë zonës së komfortit. Asnjëherë nuk kam për t'i harruar ato ditë të frohta dhe të zymta shkurti kur filluam të ndërtonim biznesin. 4-5 prezantime në ditë, ndonjëherë të 6-tin me ndihmën e sponsoreve sime **Tünde Revesz**. Dhe zgjerimi nuk na shkaktoi problem. Vetëm thellësia që nuk donte të rritej. Për 8 muaj me radhë mësova dhe mbajta shënim në leksione në mënyrë të tillë që pranë meje nuk uleshin shokët e mi të suadrës, por sponsorja ime të cilën e bombardoja gjithmonë me mijëra pyetje. Sepse nuk kisha skuadër. Por prapë s'isha nervoze dhe e zhgënjyer, por e shfrytëzoja kohën për të mësuar. Nëse s'kam njohuri, atëherë çfarë stafete do të jap mëtej? Dhe cilësia e stafetës është shumë e rëndësishme, sepse bashkëpunonjësit tanë këtë kopjojnë. Njeriu i papërgatitur më shumë dëmton se sa bën të mira, dhe sigurisht që edhe Ti mban për shembull dhe ndjek drejtuesin e vendosur dhe plot

me vetëbesim. Dituria shpërblehet gjithmonë. Kur Tünde udhëtoi në Aktivitetin e Programit Profit Sharing, erdhi thellësia. Hedhje me kokë nga trampolina, por mësova të notoj vetë dhe me siguri. Sipas ligjit të tërheqjes: herët a vonë secili tërheq rreth vetes personat, bashkëpunonjësit me mendim, interes dhe qëllime të njëjta. Edhe tek unë u thye akulli. Kur kalova 120 pikët magjike të managerit gjeta çiftin e parë të cilët jo vetëm donin ta ndërtonin biznesin, por edhe vepruan në qëllim të tij. Kështu përveç babait tim, i cili punon me mua si assistant manager, doli edhe një linjë tjetër supervisor. Jozsi dhe Editke Gulyas, faleminderit që jeni me mua! Dhe më fantastikja është që do të udhëtojmë së bashku në Stockholm dhe do të shijojmë mikpritjen e kompanisë të gjashtë, prindërit, Editke dhe Jozsi, dhe ne.

Çdo vendim paraprihet nga ndjenja, më e rënda e përcakton jetën tonë. Ligj shpirtëror: **Mendo gjithmonë për atë që dëshiron. Asnjëherë mos mendo për atë që nuk dëshiron.** Vetëm Ti përgjigjesh për realizimin e dëshirave dhe ëndrrave të tua, Ti i lëviz fijen. Jetoji ëndrrat, sepse ëndrrat mund të realizohen! Nëse do që dëshirat e tua të plotësohen, duhet të rregullosh zonën tënde të komfortit. Nëse nuk e bën këtë, gjithçka mbetet ashtu siç ishte. "Nëse nuk të pëlqen diçka, ndryshoje atë. Nëse nuk di të ndryshosh, ndrysho mënyrën e të menduarit rreth saj". Thjeshtë vetëm ndrysho qëndrimin tënd, mendo dhe jeto në mënyrë të shëndetshme, dhe jeta jote do të ndryshojë. Dikush duhet të mposhtë dyshimet, dikush mungesën e besimit në vetvete dhe dikush frikën. Beso në atë që bën dhe në aftësitë e tua, forco pamjen rreth vetvetes. Je ai që mendon rreth vetvetes, prandaj kujdes se çfarë mendon dhe thua rreth vetes, sepse i tillë bëhesh.

Këtu dëshiroj të shpreh falenderimet dhe respektin tim për ata njerëz që

më ndihmuan në arritjen e suksesit. Në radhë të parë prindërve të mi të cilët me ndihmën dhe sakrificën e tyre janë shembull, nga të cilët asnjëherë nuk më duhej të kërkoja, por prapë më japin dhe më mbushin me dashurinë e tyre. Babait tim i cili më qëndron pranë si dora ime e djathtë, me aftësinë e tij të madhe të organizimit dhe dëshirën e pafund për të dhënë.

Nënës sime e cila siguron sfondin që ne të punojmë të qetë dhe të mos na mungojë asgjë. Vajzës sime, Fani, e cila më mbështet në gjithçka, më shoqëron dhe më inkurajon me entuziazëm, të cilës shoferët e taksive ia dinë përmendësh orarin e ditës, sepse nëna i punon gjithmonë. Sponsorët e mi, **Tünde Revesz dhe Laci Kovacs**, të cilët patën besim tek unë, të cilët më motivonin dhe nxinin gjithmonë, dhe më dhanë çdo ndihmë për zhvillimin tim.

I dashur zog shqiponje, çfarë duhet të bësh? Asgjë të veçantë, thjeshtë vetëm t'u tregosh të njohurve dhe miqve të tu përvojat personale me produktet. Provoje, ka efekt! I rrethuar nga konsumatorë të kënaqur përforcohesh në faktin që po bën gjënë e duhur dhe që po ecën në rrugën më të mirë. Ti e vendos që negativiteti i të tjerëve e mbulon me mjegull rrugën drejt suksesit apo ecën me këmbëngulje deri në fund të saj. Mos e var të ardhmen tënde nga suksesi apo disfata e momentit! Në këtë biznes edhe rezultati më i vogël vlerësohet dhe shpërblehet.

Duhet ta përjetosh, duhet ta dish se çfarë ndjenje e mrekullueshme është të qëndrosh në skenë dhe të marrësh medaljen e managerit. Kjo nuk mund të thuhet apo të shkruhet, vetëm mund të përjetohet. Merr në dorë drejtimin e jetës tënde. Ndiz llampën dhe liro xhindin. Thuaj dëshirat e tua! Guxo të dëshirosh, sepse çdo gjë është e mundur! Dhe pyetjes që kur ta fillosh? Përgjigjia është: TANI!



E pamundura



KAROLY LERANT
senior manager



EDINA TOTH LERANTHNE
senior manager

Në atë kohë, përpara Forever-it, nuk para flisja përpara shumë njerëzve, madje edhe përpara pak njerëzve kisha turp. Por në këtë biznes ndodhin gjëra tepër interesante me njeriun. Dhe pikërisht që sa shumë mund të ndryshojmë në çdo fushë. Sa ndryshe mund t'i shikojmë gjërat dhe sa gjëra të tjera marrin rëndësi për ne.

Leksionit tim i dhashë titullin **E PAMUNDURA NUK EKZISTON**, dhe këtë e vërtetoi edhe fakti që tani po qëndroj këtu përpara jush, pasi 3 vjet më parë, por ndoshta edhe 1 vit më parë nuk do e besoja se njëherë Unë do të mbaj lëksion përpara 5 mijë njerëzish në Arenën Sportive të Budapestit. Edhe kjo tregon se s'ka gjë të pamundur.

Fillimisht më lejoni ta filloj me një thënie shumë të rëndësishme për mua të cilën e pashë në një shkrim reklame përpara 2,5 vitesh kur po ktheheshim në shtëpi nga një ekskursion. Mua ky shkrim më mbeti në mendje dhe që atëherë kështu veproj.

“E PAMUNDUARA është vetëm një fjalë e madhe të cilën e përdorin njerëzit e vegjël, sepse për ta është më e lehtë të jetojnë në një botë të gatshme se sa të zbulojnë në vetvete forcën për të bërë ndryshim. E PAMUNDUARA nuk është fakt, por opinion. E PAMUNDUARA nuk është deklaratë, por sfidë. E PAMUNDUARA është mundësi. E PAMUNDUARA është vetëm një moment që kalon. E PAMUNDURA NUK EKZISTON!”

Shumica e njerëzve e përdor fjalën e pamundur sepse është më e rehatshme të thuash për diçka që është e pamundur ta bësh se sa të marrësh përsipër që nga e pamundura të krijosh një mundësi për veten dhe familjen. Për fat të keq janë të paktë njerëzit që përfitojnë nga mundësia që jeta i sjell përpara, sepse s'është e sigurt që e dallojnë atëherë kur mundësia vjen, por shpeshherë atëherë kur ikën.

– Kam parë njëherë një film i cili fliste për jetën e një gengsteri. Ai quhej Bugsy dhe ishte një anëtar i

mafies dikur në vitet 1950. Thelbi është që kishte një ide, më mirë të themi një haluçinacion që të ndërtonte një kasino në shkretëtirë, sepse aty lojrat e fatit mund t'i legalizojnë. Në fillim investitorët e mafies nuk donin të dëgjonin rreth kësaj, pasi aty s'kishte ujë, s'kishte energji elektrike, ka shumë rërë, dhe kush do të shkonte të luante. Por më në fund Bugsy i bindi ata, nisi ndërtimet dhe ngriti një hotel dhe një kasino, emri i të cilit ishte: HOTEL FLAMINGO. Sot kjo kasino ndodhet në një nga qytetet më të ndritshëm, më të bukur dhe njëkohësisht me numrin më të madh të hoteleve, i cili quhet LAS VEGAS. Po të jetonte sot Bugsy, do të çuditëj që nga një ëndërr dhe një ndërmarrje që dukej e pamundur çfarë u bë. Për atë nuk ishte E PAMUNDUR!

Jam menduar shumë që kam takuar shumë njerëz gjatë 3,5 vitesh të cilët thjesht më çudisin, por nuk i kuptoj akoma. Më çudisin sepse mundësisë FLP i thanë jo sepse sipas tyre s'kanë të njohur, s'kanë kohë, nuk do ta bënin dot, s'kanë të njohur të tillë, njerëzit s'kanë para, produktet janë të shtrenjta, etj.

(Mendoj se edhe Ju keni dëgjuar pretekste të tilla apo të ngjashme.) Por pavarësisht nga kjo, duke mos e njohur të pamundurën, nga dita në ditë shkojnë në punë për 70-80 mijë Ft, nga të cilat mbajnë familjen. E them seriozisht që më mahniti angazhimi me të cilën janë në gjendje ta bëjnë. Për mua ndoshta kjo do të ishte e pamundur. Nuk dëshiroj të fyej asnjëri, por seriozisht, si mund të kalohet muaji me kaq para?

Bëra një llogari të vogël në shtëpi se si mund të jetohet me 70-80 mijë Ft në mënyrë cilësore. Më vjen keq, por ngeca tek kushti i dytë, dhe kisha prapa edhe tetë kushte të tjera.

Nuk ekziston!

Nuk i kuptoj këta njerëz, sepse kur u ofrojmë atyre këtë mundësi, të bëjnë të paktën atë që ta shikojnë dhe ta studiojnë, në rregull nuk ia besoj këtij njeriu të gjitha ato që thotë, por të paktën po e studioj që a do të funksiononte për mua. Nëse nuk do e bënit për vete, të paktën ta bënit për familjen dhe fëmijët tuaj.

E kam të qartë se përse ndodh kjo, sepse një pjesë e mirë e njerëzve kanë informacione të sakta rreth biznesit Forever. Ata e dinë mirë që ky është një sistem piramidal, një lojë pilot, dhe fiton vetëm ai që është në majë, dhe gjithë këto informacione i zotërojnë nga dorë e parë, nga fqinjët, miqtë, të afërmit, nga njerëz të cilët nuk e ndërtojnë këtë biznes, por e dinë mirë se si funksionon dhe si nuk funksionon.

E kam zakon të pyes nga njerëzit e rinj që nga kush do pranonte këshilla po të ndërtonte? Nga një mik i cili e ndërtoi shtëpinë e tij për 15 vjet, apo nga një njeri që ndërton përditë shtëpi, dhe këtë ka profesion.

Po iu tregoj një sekret: kam takuar shumë njerëz të cilët as në këtë biznes nuk arritën dot suksese të mëdha. Por fakti që dikush nuk arriti suksese këtu, përse do të thotë automatikisht që as Ti nuk do të arrish. Në anën tjetër nga e dimë



se ai që s'pati sukses në FLP bëri gjithçka në interes të pikësynimit të tij, e dëgjoji sponsorin, kishte ndihmën e duhur apo që bëri atë që duhet për t'u bërë i suksesshëm.

Kam një lajm të mirë: Juve, Mua dhe me mijëra njerëzve të tjerë në Hungari dhe në botë, produktet dhe biznesi na ofron të njëjtën gjë. Madje jam i sigurt që edhe të njohurit tanë reagojnë njëllor, ndryshimi i vetëm është që Ata i njeh Ti dhe jo unë. Atëherë përse njëri do të ketë sukses, kurse tjetri jo?

Përgjigjia është e thjeshtë: një diçka nuk është e njëjtë, mënyra se si mendojmë Unë e Ti rreth këtij biznesi.

**SUKSESIN KËRKOJE
GJITHMONË NË MENDIMET
E TUA, DHE JO NË VEND
TJETËR!**

Pasi ne drejtohem nga mendimet. Nëse vendos rregull në mendimet e tua, atëherë do të jesh në gjendje për gjithçka dhe do të kesh sukses, dhe që nga ai moment fjala E PAMUNDUR nuk ekziston më për ty.

Të lutem, nëse je akoma i ri në këtë biznes, apo je pikërisht duke u menduar për ta filluar, apo ke kohë që qëndron në të njëjtin nivel, mendo vetëm në mënyrë pozitive rreth vetes dhe biznesit Forever, sepse vetëm atëherë do e marrësh atë që dëshiron.

Si përfundim dëshiroj të falenderoj disa njerëz për faktin që ndodhemi këtu në këtë biznes të shkëlqyer dhe arrijmë suksese. Fillimisht do të falenderoja ata dy njerëz që na e sollën të gjithëve mundësinë e FLP-s, dhe Unë nuk mund të imagjinoj njerëz më të përshtatshëm se ata në këtë post. I përulemi këtyre njerëzve të cilët nga E PAMUNDURA krijuan një MUNDËSI për të gjithë ne. Faleminderit **Jozsef dhe Marika Szabo**, jeni njerëz të mrekullueshëm

dhe shembuj të faktit që s'ka gjë TË PAMUNDUR!

Dëshiroj të falenderoj sponsorin tonë **Istvan Utasi** i cili ia kërkoi numrin tonë të telefonit një të njohuri tonë dhe na ofroi këtë mundësi. Këtë do t'ia shpërblej duke ndihmuar sa më shumë njerëz që të bëhen manager.

Falenderoj njerëzit që e besuan dhe e besojnë deri më sot që ky biznes u ofron edhe atyre rrugëzgjidhje në jetë dhe u bënë Manager. Falenderoj **Zoltan Pardi-n**, managerin tonë të parë me të cilin punonim së bashku edhe në biznesin tonë të vjetër dhe i cili pavarësisht se në fillim nuk e besoi, madje më quajti edhe jo normal, prapë e ndërtoi biznesin. Falenderoj **Marti Seregelyes-in** dhe **Gabor Aradi-n** që besuan se ekziston edhe një mënyrë tjetër jete. Falenderoj **Zsuzsa Kapitany-in** dhe **Matyas Kapitany-in** të cilët për 7 muaj arritën nivelin e managerit ndërkohë që Zsuszi ishte me fëmijë të vogël dhe mund të merrej vetëm 2 orë në ditë me ndërtimin e biznesit.

Falenderoj **skuadrën tonë** që i pranojnë udhëzimet që u japim atyre. Është e mirë që në të ardhmen ai që mendon të ndërtojë biznesin e tij Forever do të marrë çdo ndihmë nga Ne.

Falenderoj linjën time të sipërme, **Robi Varga-n**, nga i cili mësova që nuk duhet të merrem me ata të cilët vetëm thonë që do ta bëjnë, por duhet të bëjmë vetëm një gjë, **TË ZGJEROJMË!**

Falenderoj **Zsolt Leveleki-n** që na mësoi si të tregohemi të përlulur me të tjerët dhe që në fillim të ndihmojmë veten tonë, pastaj të tjerët.

Falenderoj **Zsolt Fekete-n** e linjës kryqëzuese që na bëri të qartë që këtë punë ta marrim si lojë, dhe atëherë nuk do të nervozohemi që t'i fusim të gjithë me çdo kusht. Pasi edhe loja

mund të shijohet vetëm kur të gjithë e luajnë për t'u argëtuar.

Falenderoj **Istvan dhe Cili Adam-in** që atëherë na tërhoqën vëmendjen që deri kur duam të humbasim edhe 500 000 Ft të tjera, si dhe për këshillat e shumta që na ndihmuar të bëhemi Manager me gruan time.

Falenderoj **të gjithë mjekët, mjekët popullorë** që janë mes nesh, rekomandojnë produktet e FLP-s dhe ndihmojnë punon tonë. Pasi më besoni për ata është më e vështirë se për ne njerëzit e thjeshtë.

Falenderoj **Rex Maughan-in** që e ëndërroi Forever-in. Është një njeri i mrekullueshëm, shpresoj të jetë për shumë kohë me ne dhe të drejtojë biznesin Forever.

Falenderoj **Familjen time** për durimin dhe mirëkuptimin që shpeshherë kur kthehesha vonë në shtëpi nga një prezantim, e praninin se përse e bëja.

Falenderoj **djalin tim të vogël Oliver** që e kemi. Pasi Ai më jep forcë që nga dita në ditë të ngre telefonin dhe të ftoj njerëz të rinj në biznes, si dhe t'i pranoj refuzimet e njerëzve negativ.

Dhe si përfundim **falenderoj gruan time Edina dhe veten tonë** që kur Istvan Utasi na e sollti këtë mundësi, e pranuaam dhe patëm besim se jemi në gjendje ta ndërtojmë këtë biznes. Pasi dikush mund të jetë sponsori më i mirë në botë, nëse Ne nuk i themi PO kësaj mundësie, atëherë s'ka vlerë!

Më besoni, ndoshta kjo është pjesa më e vështirë e të gjithës, të luftosh me vetveten, të mposhtësh dyshimet dhe fjalën E PAMUNDUR.

Nëse jeni të aftë për këtë, atëherë do të jeni të aftë për gjithçka!



MELINDA GULYAS
senior manager

Keni dëshirë t'i kushtoni gjysëm ore zbulimit të një sekreti? Në rreshtat e mëposhtme do të gjeni metodat që më ndihmuan mua në suksesin e arritur në biznesin FLP!

Guxim për jetën

Është një nder i madh për mua që mund t'iu flas Juve, lexuesve të revistës mujore Aloe, dhe falenderoj drejtorin gjeneral Dr. Sandor Milesz për mundësinë e dhënë për shfaqjen e historisë sime.

Emri im është Melinda Gulyas dhe në të vërtetë unë jam teknike e industrisë tekstile, por s'kam punuar asnjëherë në profesionin tim, sepse pasi mbarova shkollën, që nga moshë 19 vjeç punova në një firmë tregëtie të drejtpërdrejtë. Dhe punova si tregëtare me shumë sukses për 7 vite me radhë. Gjatë kësaj kohe mësova se nëse dua të arrij diçka në jetë, duhet të punoj me guxim dhe këmbëngulje për suksesin.

Pesë vjet më parë u takova për herë të parë me formën e biznesit të ofruar nga Forever Living Products dhe sponsoren time, Eva Keszi Szepne-n, e cila më bëri të kuptoj se në jetën time ka një mungesë të madhe. "Në Marketingun Direkt s'ka TË DREJTË AUTORI dhe nuk mund t'i sigurosh dot vetes TË ARDHURA PASIVE." – tha Eva. Atëherë kuptova se unë duhet të jem e pranishme në çdo forint të nxjerrë. Unë po punoj në një sistem që paguan mirë, por që qëndron në një vend.

Nga Eva morra pikëpamje dhe udhëzime të reja, dhe natyrisht edhe libra që më nxitën të marr vendim. I lashë sukseset, vlerësimet e arritura, rrugën e shkelur me shpresën se po të ulem përsëri në "bankat e shkollës" dhe të mësoj një profesion të ri, do të jem në gjendje të ndërtoj një biznes me të drejtë autori. Pra zgjedha pavarësinë!

U realizua gjithçka, ndodhi ashtu siç premtoi Eva. Bashkimi ynë solli

suksesin e përbashkët! E falenderoj Eva-n për punën e përbashkët, për pëgatitjen që më dha, si rezultat i të cilës u ndërtua një rrjet stabil. U bëra me një skuadër fantastike dhe punoj me bashkëpunonjës të veçantë. Njerëz të mrekullueshëm më respektuan me faktin që e ndërtojnë biznesin tyre së bashku me mua, dhe besimi që kanë tek unë më jep forcë, kurse miqësia jonë e shtrenjtë është një dhuratë të cilën as nuk e kisha imagjinuar.

2006-a ishte viti më i suksesshëm i jetës sime tregëtare të deritanishme, dhe përveç veprimtarisë së plotë si këshilltare e FLP-s kisha forca dhe kohë të filloja studimet në degën e Ekonomikut të Shkollës së Lartë Robert Karoly.

Falë punës së bërë managerët e parë në skuadrën time u bënë Gabriella Peter dhe Zsolt Peter. Ky është një gëzim i madh për mua, pasi arrihet rrallë të fusësh në biznes anëtarë të familjes, dhe Gabriella pavarësisht se ishte motra ime më pranoi si sponsorë.

Supervisorët tanë Eva Müller, Klara Pal, Monika Csaki dhe Tibor Csaki, Maria Fabian dhe Karoly Fabian, Iren Bolka Surinne dhe Andras Surin, Erika Kapuvari dhe Tibor Kapuvari, si dhe Dr. Eva Baksa dhe Laszlo Szabo janë krenaria e zemrës sime, dhe së bashku me asistent managerët, Katalin Szabo Bogdanne dhe Ervin Bogdan, arritëm nivelin e qarkullimit falë të cilit në 2006-ën e përfaqësova gjashtë herë skuadrën time në skenë në Klubin e Sundimtarëve.

Më në fund në nëntor të 2006-ës lindi skuadra e dytë e managerëve me drejtimin e Kurucz Leventene



Györgyike-s dhe Levente Kurucz-it. Puna e tyre e angazhuar dhe me nivel të lartë bëri të mundur që në nëntor të arrijmë vendin e parë në Klubin e Sundimtarëve.

Dhe me ta u bëmë skuadër Seniori! Nëntori i 2006-ës ishte muaji kur FLP Hungaria arriti qarkullimin rekord. Dhe ne muajin më të mirë u bëmë me medalje ari! Në Rally-n European të Stockholmit do të udhëtojmë dymbëdhjetë vetë nga skuadra, dhe jam shumë krenare që bashkëpunonjësit e mi i marrin kaq seriozisht sfidat!

Në ditën e Aloe-s së nëntorit leksioni i Miklos Berkics-it kishte domethënie të madhe për ne. Na bindi se sfidat janë ato që të çojnë nga një nivel në tjetrin, pra është e rëndësishme marrja seriozisht e tyre! Në këtë aktivitet me ne ishte edhe Jozsef Szabo, i cili na e përforcoi bindjen që jemi në vendin më të mirë të mundshëm! Faleminderit!

Puna e kryer për pesë vjet me radhë i sollti frytet: makinë e re, shtëpi private, udhëtime me sponsorët dhe linjat e mia vëllazërore, Magdi Maretics, Marcsi Keszler dhe çifti Timar.

Cili është sekreti? **Të bëjmë punën bazë!** Hapat e kësaj janë: **1. Zbulimi i burimit të marrdhënies, 2. Ftesa, 3. Prezantime TEMATIKE, Trajtimi i preteksteve, 5. Mbyllje, 6. FEEDBACK.**

Si duhet ta zbulojmë **burimin e marrdhënieve tona**? Kjo është shumë e thjeshtë, vetëm dëgjoni kasetën e Miklos Berkics-it me titull “Turbo start” dhe krijoni me sponsorin tuaj listën e emrave.

Si të bëjmë një **Ftesë** me efekt? Më shpejt mund ta mësoni nëse dëgjoni kasetën e Miklos Berkics-it me titull “Ftesë në mënyrë profesioniste”, pastaj praktikojeni në mënyrë aktive fillimisht me sponsorin tuaj, pastaj vetëm.

Si ta prezantojmë këtë mundësi? Të organizojmë **MBRËMJE**

TEMATIKE! Qëllimi i këtyre është të rrisim efektivitetin e prezantimeve me një informim të shkurtër dhe korrekt. Në këtë mënyrë kandidati ynë ndërmjet katër mundësive merr informacion rreth temës që i intereson. Përparësia e kësaj është që duke kursyer kohë dhe energji, prazantimi i përshtatet personit, prandaj është edhe më efektiv.

a.) Mbrëmje SHËNDETI:
Shikojeni edhe Ju paletën e produkteve tona dhe zgjidhni në këtë temë 10-15 produkte! Planifikoni se cilët persona dëshironi të ftoni! Përdorni ftesë TEMATIKE! Përshembull: “Të ftoj me kënaqësi në mbrëmjen e Shëndetit ku mund të dëgjosh këshilla praktike rreth ruajtjes së shëndetit. Çaj i mirë, bisedë e lirshme. Tema: Detoksikimi dhe konsumimi i lëngjeve. Vendi, koha, mundësitë e kontaktimit.” Mbaheni leksionin me entuziazmin më të madh të mundshëm me ndihmën e Touch of Forever! Përdorni mjetet e kompanisë dhe ofrojeni mysafirëve dhe të interesuarve produktet tona, jepuni t’i provojnë!

b.) Mbrëmje KOZMETIKE:



Shikojeni edhe Ju paletën e produkteve tona dhe zgjidhni në këtë temë 10-15 produkte! Planifikoni se cilët persona dëshironi të ftoni! Përdorni ftesë TEMATIKE! Përshembull: “Të ftoj me kënaqësi në mbrëmjen e Kozmetikës ku mund të përdorësh maskën tonë të re dhe kompletin tonë kozmetik “Lulja e rinisë”. Tema, ide, përvoja, provimi i produkteve që trajtojnë lëkurën dhe kozmetike, provimi i disa produkteve të tjera, vendi, koha, mundësitë e kontaktimit.” Mbajeni leksionin me shumë entuziazëm dhe me ndihmën e mjeteve! Mysafirët tuaj ta ndiejnë nga jashtë e brenda efektin e mrekullueshëm të Aloe-s!

c.) Mbrëmje DOBËSIMI:



Shikojeni edhe Ju paletën e produkteve tona dhe zgjidhni gjithë produktet që ndihmojnë rënien e shëndetshme nga pesha, pastaj ruajtjen e peshës së arritur! Planifikoni se cilët persona dëshironi të ftoni! Funksonioni rregullisht klubin e Dobësimi! Përdorni ftesë TEMATIKE! Përshembull: “Të ftoj me kënaqësi në programin me titull” Më formohet forma”. Tema: Të mësojmë të pijmë! Të dobësohemi së bashku! Provë. Matje e dhjavit të trupit. Receta, ide, imtësi. Sill të dashurën dhe të afërmit e tu, edhe ata i presim me kënaqësi! Vendi, koha, mundësitë e kontaktimit! Mbaheni mbrëmjen e Dobësimi me entuziazëm, përdorimin e mjeteve, matje dhe kryesisht në një atmosferë miqësore!

d.) Rekomandimi i BIZNESIT: Bashkëpunoni në mënyrë aktive me sponsorin tuaj! Përdorni materialet e kompanisë: prospekt produktesh, FLP flipchert, libri me titull Pastër dhe Thjeshtë, katalogë, revista mujore Aloe, libra prezantues të Network Marketing, përshembull: Robert G. Allan - Network Marketing, si makineri që bën para, Robert T. Kiyosaki – Shkolla e biznesit, CD, kasete, etj. Është mirë të punoni në grup, ose në kombinim 2:1 dhe 1:1, pra në një formë të zgjedhur sipas kërkesave dhe nevojave të kandidatit. Sipas thënies – “Një provë s’është provë!”. Realizimi do të jetë emocionues, kurse suksesi i ëmbël.

Sipas një thënie tjetër: “Praktika e bën mjeshtrin!” Në profesionin tonë kjo duket më mirë gjatë **trajtimit të preteksteve**. Praktikojë vazhdimisht, pra bëje, bëje, bëje...!!! Për këtë ju vjen në ndihmë kasete e soaring manageres Eva Keszi Szepne-s me titull “Trajtim pretekstesh në mënyrë profesioniste” dhe libri i Allan Pease me titull “Të pyesësh duhet të dish”.

Biseda juaj të pasohet gjithmonë nga **mbyllja**. Këtë shpeshherë e harrojmë. Pyesni pa frikë, por gjithmonë me empati maksimale. Përshembull: “Çfarë iu tërhoqi?”, “Çfarë iu pëlqeu më shumë?”, “Çfarë dëshironi të provoni në fillim?”, “Në ç’mënyrë dëshironi ta përvetësoni atë?”, “Kur mund të takohemi, të martën apo të enjten, që të diskutojmë pyetjet dhe mendimet tuaja të mëtejshme?”. Mblidhni pyetjet në mënyrë që në çdo situatë të jeni gjithmonë të përgatitur me pyetje!

“Feedback” është fjalë angleze e cila në shqip do të thotë **KUNDËRPËRGJIGJE**. Kjo metodë

të jetë pjesë e rëndësishme edhe e punës suaj si drejtues!

As Ju mos i harroni blerësit! **KUJDESI PËR BLERËSIT** është një nga veprimet Feedback që unë bëj vazhdimisht dhe rregullisht çdo ditë. Atë që e kam “zbutur” e kam për detyrë ta shërbej dhe përpiqem ta mbaj për kohë të gjatë si përdorues produktesh! Ju lutem, dëgjoni kasetën e Zsuzsa Banhegyi-t me titull “Kujdesi për blerësit në mënyrë profesioniste” dhe të Krisztina Kovacs Jungne-s me titull “E di se përse të paguajnë?”. Këto janë mjetet ndihmëse më të mira në këtë temë.

Detyra ime tjetër feedback është ndjekja e vazhdueshme e **BASHKËPUNONJËSVE**. Edhe ata i mbështes në punën e tyre tregëtare duke i ndihmuar me kundërpërgjigje të



vazhdueshme. Kënaqësia më e madhe në këtë punë është biseda feedback me bashkëpunonjësit e zellshëm dhe të motivuar pas aktiviteteve të suksesshme.

S’mund të lihet pas dore as feedback-u pas konsultimeve, pasi ky është mjeti më efektiv i kuptimit të fakteve të dalluara. “Një biznes mund të ndërtohet nëpërmjet prezantimeve, por një perandori mund të krijohet vetëm me konsultime ndërmjet dy ose tre personave”.

Pra, nga se përbëhet **PUNA BAZË?** Shkruani listën e emrave, kontaktoni me të njohurit tuaj dhe prazantojuni mundësinë e FLP-s në mënyrë **TEMATIKE!** Praktikoni pa frikë trajtimin e preteksteve! Prezantimi të pasohet gjithmonë nga mbyllja, dhe mos kurseni asnjëherë me kundërpërgjigjen, pasi me **FEEDBACK** mund ta bëjmë efektive punën tonë!

Vendime, ndryshime, sponsor, skuadër, suksese, sfida, disfata, gëzime, refuzime, aktivitete, kualifikime, e kështu mëtej, mund t’i radhisja më gjatë fjalët që ndoshta edhe për Ju tregojnë shumë gjëra rreth këtij profesioni.

I dashur Lexues! Me mundësinë e ofruar nga FLP-ja mund të arrini gjithçka që imagjinoni! Çfarë më dha mua FLP-ja? Shpresoj se e kuptuat nga këto rreshta. Merrni forca nga sukseset e sponsorëve tuaj, ndryshoni rutinën e ditëve të zakonshme dhe punoni me këmbëngulje, sepse rezultati është **SUKSES**.

“Anëtarët më të pasur të komunitetit tonë njerëzor janë ata që janë në gjendje të japin pa e ndjerë aspak që Atyre u mbeti më pak.”

Shtypi

Botuese: Kompania Forever Living Products, Hungari.

Redaktoi: FLP Magyarországi Kft. 1067 Budapest, Szondi u. 34. Telefon: (36-1) 269-5373 Fax: (36-1) 312-8455

Redaktori kryesor: Dr. Milesz Sándor

Redaktor: Kismárton Valéria, Veress Angéla, Rókás Sándor

Fotografia e kopertinës: Bakos Veronika

Përgatitja për shtypje: Tipofill 2002 kft.

Grafika: Teszár Richárd, Buzássy Gábor

Shtypi: Veszprémi Nyomda Zrt. U përgatit në 49 250 kopje

Për përmbajtjen e artikujve shkruarit mbajnë përgjegjësi! Çdo e drejtë mbrohet!

Përkthyes, redaktues: shqip: Dr. Marsel Nallbani – kroat: Darinka Aničić, Anić Antić Žarko

– serb: Tóth-Kása Ottilia, Molnár Balázs, Meseldžija Dragana – sloven: Novak Császár Jolanda, Biro 2000 Ljubljana

Qendra Kozmetike dhe Mësimore në Kroaci

Me kënaqësi të madhe iu njoftojmë se më 1 dhjetor 2006, në katin e parë të zyrës së Zagrabit të Forever Living Products të Kroacisë me adresë Ulica grada Mainza 21, u hap Qendra Kozmetike dhe Mësimore – Sonya.

Në hapjen solemne të Qendrës, në praninë e bashkëpunonjësve dhe managerëve tanë drejtues, bashkëpunonjësja jonë senior managere, Manda Korenic, një nga përdorueset më të zellshme të produkteve kozmetike, preu shiritin dhe hapi zyrtarisht Qendrën tonë Kozmetike dhe Mësimore – Sonya.

Qëllimi i funksionimit të Qendrës Përgatitore është që përdoruesit e produkteve FLP të njohin sekretet dhe forcën madhështore të familjes së lëndëve kozmetike Sonya.



Orari i hapjes: E hënë: 16:00 – 20:00, e martë dhe e mërkurë: 15:00 – 19:00, e enjte: 16:00 – 20:00, e premte: 13:00 – 17:00.

Takimi mund të lihet në numrin e telefonit: + 00 385 1/ 3909 773

Përgatiteni fytyrën dhe trupin tuaj për atmosferën e festave, shkoni me besim dhe çmim të favorshëm tek specialistja dhe drejtuesja e Qendrës, Gordana Geric.

TRAJTIME FYTYRE:

(Trajtim fytyre me pastrim, fshirje fytyre, maskë, trajtim tini, Lulja e Rinisë, Luftë kundër rrudhave, Magjia e detit, hidratim i thellë, bombë gjallëruese)

MAKIJAZH

(ditor, për rast)

NGJYROSJE

(qepallash, qerpikësh)

KOLOFON

(heqje vetullash, kolofon mustaqesh, kolofon zonash intime, kolofon i gjithë këmbës, kolofon i pjeshëm këmbë, kolofon krahu)

MASAZH

(masazh fytyre, masazh shpute, masazh refleksesh shpute, masazh i pjeshëm, masazh tradicional i gjithë trupit, masazh kundër celulitit, masazh kundër stresit)





FOREVER RESORTS

HOTEL KASTÉLY SZIRÁK

Adresa: Hotel Kastély Szirák
3044, Szirák, Petőfi út 26.

Tel.: (0036) 32-485-300

E-mail: kastelyszirak@globonet.hu



Senya[®]
Color Collection

